



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 855/4 Prot.

Tiranë, më 26.09.2025

V E N D I M

Nr. 223, Datë 26.09.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 132, datë 30.05.2025, e znj. I.M kundër Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a¹ (UKE), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjinisë”, “gjendjes familjare²”, “gjendjes ekonomike³”, “gjendjes shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër⁴”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, informon se: “Banoj në Lagjen “5 Maji”, Rruga: “Aleks Buda”, Pall. 720/3, Apt. 10, dhe jam e divorcuar. Banesa është objekt i një procesi gjyqësor të hapur me ish bashkëshortin dhe për të ekziston një vendim i gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan (nr. 1883, datë 17.12.2020), i cili siguron të drejtën time të përdorimit të apartamentit derisa çështja të marrë vendim të formës së prerë. Prej afro 10 ditësh, UK Elbasan, ndërpreu furnizimin me ujë, por pas 2 ditësh e rilidhi, për shkak të ankesës sime, deri sa të verifikonte dokumentet, por sot me datë 29.05.2025, njofton se do ndërpresi ujin e pijshëm në këtë

¹ NIPT M23322201V

² Si grua e divorcuar, nënë e një djalë madhor, që ka vuajtur dhunë në familje.

³ Referuar Vërtetimit nr. 019474 serie, datë 29.05.2025 të Bashkisë Elbasan, znj. I.M, trajtohet me ndihmë ekonomike për dy persona në masën 3.703 lekë. Referuar Vërtetimit datë 27.05.2025 të DR AKPA Elbasan, znj. I.M është e regjistruar si punëkëruese e papunë.

⁴ Pa përcaktuar një cilësi personale apo shkak.

banesë, për shkak të një debie financiare prej 237.128,22 lekësh, që figuron në emër të bashkëshortit tim, G.T.

Përkundër faktit që nuk jam titullare e kontratës dhe nuk kam borxh në emrin tim, jam trajtuar si debitor, duke u kushtëzuar me pagesë të 1/5 e saj (47.000 lekë të menjëhershme) së pretenduar, për të pasur akses në një shërbim jetik.

Kam kërkuar me shkrim që të më mundësohet pagesa e muajve aktualë të konsumit ose të më lejohet një pagesë simbolike mujore (500-1000 lekë), derisa të zgjidhet çështja në gjykatë. Kjo është refuzuar kategorikisht nga UK Elbasan, duke e kushtëzuar rilidhjen e ujit me pagesën e menjëhershme të të gjithë shumës”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, rilidhjen e furnizimit me ujë dhe ti rishikohet shuma mujore për pagesat e prapambetura nga 3.000 lekë, në shumën 500-1000 lekë në muaj, sipas kushteve të saj ekonomike.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës të paraqitur nga ankuesja, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 855/1, datë 16.06.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a, për ankesën e bërë, si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:
 - Parashtrime me shkrim, lidhur me situatën e pretenduar nga subjekti ankues.
 - Kopje të kontratës së furnizimit me ujë dhe çdo lloj dokumentacioni shoqëruar kontraktor, të lidhur midis palës ankuese dhe shoqërisë.
 - Informacion në lidhje me gjenden e detyrimeve/debisë që ankuesja ka ndaj shoqërisë, shoqëruar me kopje të dokumentacionit përkatës provues.
 - Informacion në lidhje me procedurën e ndjekur në lidhje me ndërprerjen e furnizimit me ujë të banesës ku jeton ankuesja, shoqëruar me dokumentacionin përkatës në lidhje me procedurën e ndjekur, si dhe kuadrin ligjor dhe nënligjor ku bazohet procedura e ndjekur.
 - Informacion nëse ofrohen lehtësira ose përjashtime për kategori të ndryshme vulnerabël? Nëse po, çfarë lehtësirash ose përjashtimesh zbatohen, cilat janë kategoritë përfutuese dhe cila është procedura që ndiqet nga ana e shoqërisë për zbatimin e tyre.

Me shkresën nr. 1063/1, datë 20.06.2025, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a, informoi Komisionerin se: *“Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime, në morinë e lartë të abonentëve të saj, një pjesë e madhe e të cilëve janë abonentë të rregullt, të cilët paguajnë rregullisht, çdo Faturë Tatimore të shitjes së ujit të pijshëm, çdo muaj, ka dhe abonentë të cilët nuk kanë respektuar detyrimin e pagesës sipas kushteve ligjore dhe janë abonentë debitorë ndaj UKE-së, duke ju shprehur me bindje se nuk ka vend për diskriminim të znj. I.M, ish bashkëshortja e z. G.T.*

Një abonent, i cili nuk ka paguar detyrimin ndaj UKE-së është dhe z. G.T, ish bashkëshorti i znj. I.M, i cili rezulton të jetë debitor nga Janari i vitit 2011.

Kontrata është lidhur me zotërinë shumë më parë se viti 2011, por para datës 1 Janar 2011, të gjitha debitë e abonentëve ndaj ujësjiellës kanalizimeve janë amnistuar, duke u falur të gjitha detyrimet, gjokat, kamat-vonesat në lidhje me Ndërmarrjen e Ujësjiellësit.

Për periudhën nga 1 Janar 2011 deri në 31 Tetor 2021, Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me kërkesën për lëshim Urdhri Ekzekutimi (datë 06.01.2022) për abonentin G.T, me nr. Kontrate 23060, pas së cilës Gjykata mori Vendimin nr. 57913-2023-372, datë 01.02.2022, dhe vendosi:

- *Pranimin e kërkesës për lëshim të Urdhrit të ekzekutimit.*
- *Urdhërimin e shërbimit Përmbarrimor të kryejë ekzekutimin e detyrueshëm të Faturave të Ujit të Pijshëm lëshuar nga kërkuesi “Ujësjiellës Kanalizime Elbasan” sha, ndaj G.T, në vlerën 170.071,6 lekë, vendim i formës së prerë.*

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime, ende nuk e ka dërguar në përmbardim për ekzekutim këtë vendim të Gjykatës dhe duke qenë se është brenda kuadrit ligjor të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit, është ende në pritje të një zgjidhje sa më efektive dhe lehtësuese për kontratën e mësipërme, nga personat e përmendur.

Përsa i përket përshkrimit të ankesës së znj. I.M, ish bashkëshorte e z. G.T, po ju vëmë në dispozicion të gjithë korespondencën nëpërmjet e-maileve, bashkëngjitur kësaj shkrese.

Në datën 22.05.2025, nga kontrolli i Task Forcës së Shoqërisë, për të gjithë abonentët debitorë, u bë ndërprerja e ujit të pijshëm. Abonenti, i cili banon në këtë banesë sipas pretendimit të znj. I.M dhe vendimit të gjykatës të sipërcituar nga vetë ajo, është i detyruar të paguajë ujin e konsumuar. Ajo rezulton të ketë qenë bashkëjetuese me ish bashkëshortin dhe fëmijët në po këtë banesë me nr. Kontrate të ujit 23060 edhe përpara vitit 2020, (vit kur gjykata ka vendosur përdorimin e banesës nga ajo deri në përfundim të procesit) dhe kurrësi nuk mund t'i shmanget përgjegjësisë për pagesën e ujit nga Janari 2011, se kontrata, pavarësisht se është në emër të z. T, të dy bashkëshortët kanë detyrimin e përbashkët të pagesës së ujit, ndaj znj. I.M nuk mund t'i shmanget përgjegjësisë duke u shprehur se: “nuk jam titullare e kontratës dhe nuk kam borxh në emrin tim” pasi përgjegjësia e kësaj debie para momentit kur zonja banon e vetme në banesë sipas vendimit të gjykatës, bie mbi të dy bashkëshortët.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime, në mënyrë që vendimet e urdhrave të ekzekutimit, dalë me Vendim nga Gjykata, për pagesat e detyrimeve të prapambetura, për abonentët debitorë, për t'u shmangur nga vazhdimi i procedurave përmbardimore, gjithmonë në ndihmë të qytetarëve, ka miratuar një paketë lehtësuese për hartimin e një akt-marrëveshje me kushte të lehtësuara, miratuar me vendim të Asamblesë së Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan në Prill 2024, me kushtet e parashikuara nga kjo aktmarrëveshje (i është bërë me dijeni zonjës).

- 1. 1/5 e vlerës totale paguhet në momentin e lidhjes së akt-marrëveshjes.*
- 2. Kësti mujor çdo muaj në datën e përcaktuar në akt-marrëveshje do të paguhet një faturë nga debia dhe fatura aktuale.*

Pas ankesës së paraqitur të zonjës drejtuar me e-mail Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime në llogarinë e saj dhe me premtimin nga vetë ajo se do të vinte për të gjetur një zgjidhje me ne, si dhe me pretendimin se nuk ishte njoftuar për prerjen e ujit, menjëherë u bë rilidhje e ujit, me besimin se znj. I.M do të pranonte propozimin që iu ofrua sipas rregullave të miratuara të SHRUKES.

Pra, me zonjën kemi konsumuar një bisedë shteruese për kushtet e aktmarrëveshjes, ndërkohë që znj. I.M nuk na ka vënë në dispozicion asnjë dokument që vërteton gjendjen e saj gjyqësore, ekonomike, shëndetësore, siç dhe ka premtuar në korespondencën nëpërmjet emaileve.

Gjithmonë kemi qenë të gatshëm për të ndihmuar dhe lehtësuar këdo qytetar, pa asnjë lloj diskriminimi, duke i trajtuar të gjithë të barabartë, me qëllimin e vetëm për t'i dhënë zgjidhje të drejtë çdo lloj ankese të tyre, por, respektimi i ligjit mbetet prioritet pa cenuar askënd dhe pa asnjë lloj dallimi”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesja nëpërmjet e-mail-it datë 23.06.2025, është njohur me përgjigjen e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a.

Në përgjigje të informacionit të dërguar nga Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a, ankuesja me email-in datë 23.06.2025, ka kundërshtuar përgjigjen e dhënë nga Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a duke parashtruar në mes të tjerash se: *“Theksoj se nuk jam unë personi që kam nënshkruar me ujësjiellësin kontratën për furnizimin me ujë të pijshëm, por ish bashkëshorti im G.T. UK Elbasan, të kishte marrë masa që t’i vilte detyrimet që ka ish bashkëshorti dhe jo të mi kërkojë mua. Në banesën në fjalë unë disponoj vetëm një dhomë. Unë nuk mund të paguaj detyrimet e një personi që nuk kam më lidhje. UK Elbasan, nuk është Gjykatë të vendosi në lidhje se si do ndahen detyrimet apo pasuritë, kjo është vullneti i palëve dhe eskuziviteti i Gjykatës. UK Elbasan, të mos ngatërrojë rolin publik me atë të Gjykatës. Nëse do, UK Elbasan, të vjeli detyrimet personit kontraktor. Në të kundërtën, UK Elbasan, të hapi një sahat uji vetëm për dhomën që jeton ankuesja I.M.*

Unë kurrësi nuk kam pretenduar që të kem akses në ujë dhe të mos paguaj. Por kam kërkuar në një shumë të arsyeshme dhe propocionale me kushtet ekonomike 3.707 lekë në muaj. Kushtet e vendosura nga UK Elbasan, për 1/5 e vlerës së shumës së debisë (47.000 lekë) + 1 faturë nga vitet e kaluara + 1 faturë nga konsumi aktual, është sa 30 fishi i ndihmës ekonomike që unë marr në muaj.

Sa i përket pretendimit të UK Elbasan, se unë znj. I.M, nuk kam paraqitur dokumentet, nuk është e vërtetë dhe është një veprim i ulët nga ana e shoqërisë UK Elbasan, duke mos thënë të vërtetën Komisionerit. Le të hapen kamerat e shoqërisë UK Elbasan, në datën 29.05.2025, kur unë jam paraqitur në drejtorinë Juridike ku kam treguar dokumentet që Komisionerit ia kam vendosur në dispozicion. Gjithashtu, po në këtë datë, kam takuar edhe zv.Drejtorin e UK Elbasan z. Ç, ku nuk më dhanë asnjë zgjidhje, përveç pagesës së menjëhershme prej 47.000 lekë + 1 muaj të prapambetur + muajin aktual të konsumit”.

Me email-in datë 11.07.2025, ankuesja ka informuar se me datë 10.06.2025, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a, i ka ndërprerë furnizimin me ujë të pijshëm duke i hequr matësin (sahatin).

Në përgjigje të kërkesave të email-it datë 14.07.2025, të dërguar nga Inspektori i çështjes, ankuesja me email-in datë 14.07.2025 ka dërguar kopje të Vendimit të Gjykatës për zgjidhjen e martesës, certifikatës familjare dhe referimit elektronik të datës 25.02.2025, në të cilën znj. I.M është me diagnozën diabet mellitus tipi 2.

Me email-et datë 31.08.2025 dhe datë 11.09.2025, ankuesja ka informuar se: *“Pas presioneve të vazhdueshme UK Elbasan përsëri e ndërpreu furnizimin me ujë në muajin korrik, duke më lënë me javë pa ujë, duke më bërë presion që të paguaj ujin. Ndodhur në këtë tryzni dhe presion nga UKE, si edhe duke parë që prej afro 1 muaji mbeta pa ujë, në datë 22.07.2025, u detyrova të paguaj (duke marrë hua nga familjarët e mi) shumën prej 30.188,37 lekë fatura të konsumit të ujit për*

periudhën dhjetor 2023 deri qershor 2025, plus 3.000 lekë për rilidhjen e furnizimit me ujë, plus aktmarrëveshja 3.000 lekë në muaj për faturat e prapambetura, që është sa masa e ndihmës ekonomike që unë marr”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të subjektit ankues.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankueses, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet se: *“1. Ndalohej diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedurë, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.*

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e saj për të përfituar të mira apo shërbime nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a dhe më konkretisht në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm të banesës ku jeton.

Në bazë të nenit 23 “*Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike*”, të ligjit Nr. 139/2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”, të ndryshuar, përcaktohet se, në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre, ndër të tjera për prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.

Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a, është një shoqëri e cila është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, i ndryshuar. Megjithatë, ajo është një shoqëri e cila, referuar ekstraktit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, është në pronësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkive Elbasan, Cërrik, Librazhd, Gramsh, Peqin dhe Belsh, të ndara sipas aksioneve të kësaj shoqërie.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, që zotëron aksionet më të mëdha të shoqërisë dhe Bashkia Elbasan, si aksionarja e dytë më e madhe e kësaj shoqërie, e cila në bazë të nenit 23, të ligjit nr. Nr. 139/2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”, të ndryshuar, është përgjegjëse për prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm, të qytetarëve që jetojnë në juridiksionin e saj e ushtron këtë funksion të saj nëpërmjet personit juridik Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a. Në këtë mënyrë marrëdhënia e krijuar midis ankueses dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a është një marrëdhënie midis individit dhe një autoriteti publik/shtetit.

Bazuar në parashtrimet, kronologjinë e ngjarjeve dhe dokumentacionin e depozituar nga palët në këtë proces, Komisioneri vëren se:

Referuar Vendimit civil nr. 180 (13-2019-958), datë 11.02.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, të lënë në fuqi me Vendimin nr. 10-2020-342, datë 27.01.2020 të Gjykatës së Apelit Durrës, rezulton se ankuesja ka zgjidhur martesën me z. G.T dhe fëmija R.T i datëlindjes 31.07.2002, i është lënë për rritje dhe edukim znj. I.M.

Referuar shkresës nr. 8596, datë 15.04.2025, të Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, vërtetohet se pranë kësaj gjykate po gjykohet çështja me nr. 21286-01385-30-2024, nr. 629 Akti, datë regjistrimi 26.03.2024, me Paditës: Znj. I.M; I Paditur: Enti Kombëtar i Banesave, Dega Rajonale Elbasan; me Objekt: “1. Detyrimin e të paditurit të më njohë bashkëpronare të apartamentit 1+1, gjendur në lagjen “5 Maji”, rruga: “Aleks Buda”, Pall. 720/3, kati 4, apt. 11, Elbasan, me sip. 51.06 m², me bashkëpronar tjetër shtetasin G.T. 2 Detyrimin e ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan të rregjistrojë këtë pasuri në favor dhe në bashkëpronësi të mua paditëses. 3. 4.”.

Rezulton se martesa e znj. I.M është zgjidhur në vitin 2019, por pretendimet pasurore të palëve, lidhur me banesën janë ende në proces vlerësimi gjyqësor dhe ankuesja që prej vitit 1995 kur ka qenë e martuar dhe deri më sot që është e divorcuar ka banuar në të njëjtën banesë.

Referuar korrespondencës me email mes palëve dhe me Komisionerin, rezulton se:

Mes Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a dhe z. G.T është lidhur Kontrata me nr. E23060, për furnizimin me ujë të pijshëm të apartamentit ku aktualisht jeton dhe ankuesja, banesë e cila që nga viti 2011 ka akumuluar një debi prej 237.128,22 lekë.

Për arsye të mos shlyerjes së debisë, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a në datë 22.05.2025, ka bërë ndërprerjen e furnizimit me ujë të apartamentit ku banon ankuesja.

Ankuesja me email-et datë 23.05.2025 dhe 28.05.2025 ka kundërshtuar ndërprerjen e furnizimit me ujë të pijshëm të banesës së saj, duke shpjeguar arsyet e mospagesës së detyrimeve, dhe Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a ka kryer rilidhjen e furnizimit me ujë të banesës. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a ka kërkuar nga ankuesja që në bazë të aktmarrëveshjes të kryejë pagesën e 1/5 të vlerës totale të debisë (47.000 lekë), plus një faturë mujore nga debia dhe faturën mujore të konsumit të ujit të pijshëm.

Në datë 10.06.2025, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a ka bërë përsëri ndërprerjen e furnizimit me ujë të pijshëm të banesës ku jeton ankuesja.

Në datë 22.07.2025, ankuesja ka kryer pagesën e plotë në shumën prej 30.188,37 lekë fatura të konsumit të ujit për periudhën dhjetor 2023 - qershor 2025, plus 3.000 lekë për rilidhjen e furnizimit me ujë, plus aktmarrëveshja 3.000 lekë në muaj për faturat e prapambetura dhe i është rilidhur furnizimi me ujë të pijshëm të banesës.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga ankuesja, rezulton se znj. I.M trajtohet me ndihmë ekonomike për dy persona në shumën 3.703 lekë dhe është e regjistruar si punëkërkuese e papunë dhe nuk ka të ardhura të tjera.

Ndërkaq, rezulton e pranuar nga palët, se, subjekti ankues banon në atë adresë dhe banesa furnizohet me ujë të pijshëm që para vitit 2011, dhe se kontrata është në emër të ish bashkëshortit të ankuseses z. G.T.

Lidhur me sa më sipër, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a, ka mbajtur qëndrimin se ka ndërprerë furnizimin me ujë të pijshëm të apartamentit ku banonte ankuesja për arsye se që nga viti 2011, abonenti rezultonte debitor në shumën 237.128,22 lekë dhe se ankuesja nuk i ka vënë në dispozicion asnjë dokument që të vërtetonte gjendjen e saj gjyqësore, ekonomike apo shëndetësore.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga palët, rezulton se ankuesja me email-in datë 22.05.2025, ditën kur i është bërë ndërprerja e furnizimit me ujë të pijshëm, ka vënë në dijeni Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a (ukrajonielbasan@gmail.com) se: *“Kam një vendim gjyqësor të cila aktualisht, banesa më është lënë mua deri sa çështja e pronësisë të marrë zgjidhje”*. Po ashtu, ankuesja në datë 23.05.2025, i është drejtuar me email dhe zyrës së bashkëqëverisjes, në të cilën ka informuar se: *“... Prej vitit 2020 jam në një proces gjyqësor për shtëpinë në fjalë me ish burrin. Jam viktimë e dhunës në familje, kryefamiljare, e papunë, etj. Unë kam një vendim gjyqësor që më lejon të rri në shtëpi deri sa çështja të zgjidhet nga Gjykata e Apelit Tiranë. Nuk*

kam mundësi të paguaj detyrimet e ish burrit, pa u zgjidh çështja me gjyq. Të paktën të paguaj faturat e muajit që unë do të harxhoj”.

Gjithashtu, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me shkresën nr. 855/1, datë 16.06.2025, ka vënë në dijeni Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a për ankesën e znj. I.M, në të cilën e ka informuar se ankuesja trajtohet nga Bashkia Elbasan, me ndihmë ekonomike në masën 3.703 lekë dhe se është e regjistruar si punëkërkuese e papunë.

Për sa më sipër, bie poshtë pretendimi i Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a se nuk ka qenë në dijeni të gjendjes gjyqësore dhe ekonomike të znj. I.M dhe se ka qenë në kushtet e urgjencës për ti ndërprerë furnizimin me ujë të apartamentit ku banonte ankuesja, për shkak se ishte debitor, ndërkohë që kishte që në vitin 2011 që ishte në dijeni të debisë së kontratës dhe nuk kishte marrë masa për ndërprerjen e furnizimit me ujë të pijshëm të banesës.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, sanksionon se, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë. (Neni 3, i Kushtetutës)

E drejta e njeriut për ujë, është e domosdoshme për të jetuar një jetë me dinjitet dhe është parakusht për realizimin e të drejtave të tjera të njeriut. Një sasi e mjaftueshme e ujit të sigurt, është e nevojshme për të parandaluar vdekjen nga dehidratimi, për të zvogëluar rrezikun e sëmundjeve të lidhura me ujin dhe për të siguruar konsumin, gatimin, kërkesat higjienike personale dhe shtëpiake.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në nenin 11 sanksionohet e drejta për një standard të përshtatshëm jetese, ndërsa në nenin 12, e drejta për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit. Konkretisht, në paragrafët 1, të nenit 11 dhe 12, të këtij Pakti sanksionohet: “ (neni 12 (1.) Shtetet palë të këtij Pakti njohin të drejtën e secilit për një standard të përshtatshëm të jetesës për vete dhe për familjen e tij, duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin të përshtatshëm si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës. (Neni 12 (1.) Shtetet palë të këtij Pakti njohin të drejtën e secilit për të pasur gjendje sa më të mirë shëndetësore, fizike e mendore që ai është i aftë të arrijë”.

E drejta për ujë hyn qartë në kategorinë e garancive thelbësore për sigurimin e një standardi të përshtatshëm jetese, veçanërisht pasi ajo është një nga kushtet më themelore për mbijetesë. E drejta për ujë është gjithashtu e lidhur pazgjidhshmërisht me të drejtën për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit (neni 12, paragrafi 1 i Paktit) dhe të drejtat për strehim të përshtatshëm dhe ushqim të përshtatshëm. (neni 11, paragrafi 1 i Paktit)

E drejta për ujë është njohur në një sërë dokumentesh ndërkombëtare. Për shembull, neni 14, paragrafi 2, i Konventës së OKB-së “Për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave” parashikon që Shtetet palë do t’u sigurojnë grave të drejtën për të “gëzuar kushte të përshtatshme jetese, veçanërisht në lidhje me furnizimin me ujë”. Neni 24, paragrafi 2, i Konventës së OKB-së Për të Drejtat e Fëmijëve, u kërkon shteteve palë të luftojnë sëmundjet dhe kequshqyerjen “nëpërmjet ofrimit të ushqimeve të duhura ushqyese dhe ujit të pijshëm të pastër”.

Në Komentin e Përgjithshëm Nr. 15 (2002) “*E drejta për ujë*”, Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturor, në cilësinë e autoritetit i cili monitoron dhe interpreton Paktin, ofron udhëzime në lidhje me çështje thelbësore që lidhen me zbatimin e neneve 11 dhe 12, të Paktit Ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Disa prej këtyre udhëzimeve, të cilat Komisioneri vlerëson se gjejnë zbatim në çështjen objekt shqyrtimi janë pasqyruar si më poshtë:

Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 15 (2002) “*E drejta për ujë*” thekson se: “*E drejta e njeriut për ujë, i jep të drejtë të gjithë personave për ujë të mjaftueshëm, të sigurt, të pranueshëm, fizikisht të aksesueshëm dhe të përballueshëm për përdorim personal dhe shtëpiak*”.

E drejta për ujë përmban liri dhe të drejta. Liritë përfshijnë të drejtën për të ruajtur aksesin në furnizimet ekzistuese të ujit të nevojshme për të drejtën për ujë, dhe të drejtën për të qenë i lirë nga ndërhyrjet, siç është e drejta për të qenë i lirë nga shpërbimet arbitrare ose ndotja e furnizimeve me ujë. Të drejtat përfshijnë edhe të drejtën për një sistem të furnizimit dhe menaxhimit të ujit që ofron mundësi të barabarta për njerëzit që të gëzojnë të drejtën e ujit. Elementet e së drejtës për ujë duhet të jenë të përshtatshme për dinjitetin, jetën dhe shëndetin e njeriut. Përshtatshmëria e ujit nuk duhet të interpretohet ngushtë, thjesht duke iu referuar sasive dhe teknologjive vëllimore. Uji duhet trajtuar si një e mirë sociale dhe kulturore dhe jo të shihet kryesisht si një e mirë ekonomike.

Ndërsa përshtatshmëria e ujit që kërkohet për të drejtën për ujë mund të ndryshojë sipas kushteve të ndryshme, faktorët e mëposhtëm zbatohen në të gjitha rrethanat:

- (a) *Disponueshmëria*. Furnizimi me ujë për çdo person duhet të jetë i mjaftueshëm dhe i vazhdueshëm për përdorime personale dhe shtëpiake. Këto përdorime zakonisht përfshijnë pirjen, kanalizimet personale, larjen e rrobave, përgatitjen e ushqimit, higjienën personale dhe shtëpiake. Sasia e ujit në dispozicion për çdo person duhet të korrespondojë me udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh). Disa individë dhe grupe mund të kërkojnë gjithashtu ujë shtesë për shkak të shëndetit, klimës dhe kushteve të punës;
- (b) *Cilësia*. Uji i nevojshëm për çdo përdorim personal ose shtëpiak duhet të jetë i sigurt, pa mikroorganizma, substanca kimike dhe rrezique radiologjike që përbëjnë një kërcënim për shëndetin e një personi. Për më tepër, uji duhet të jetë i një ngjyre, ere dhe shije të pranueshme për secilin përdorim, personal ose shtëpiak.
- (c) *Aksesueshmëria*. Uji dhe objektet e shërbimit e ujit duhet të jenë të aksesueshme për të gjithë pa diskriminim, brenda juridiksionit të shtetit palë. Aksesueshmëria ka katër dimensionet e mëposhtme:
 - (i) *Aksesueshmëria fizike*: uji dhe objektet e shërbimit e përshtatshme të ujit, duhet të jenë brenda mundësive të sigurta fizike për të gjitha shtresat e popullsisë. Uji i mjaftueshëm, i sigurt dhe i pranueshëm duhet të jetë i aksesueshëm brenda ose në afërsi të çdo familjeje, institucioni arsimor dhe vendit të punës. Të gjitha objektet dhe shërbimet e ujit duhet të jenë të cilësisë së mjaftueshme, të përshtatshme nga ana kulturore dhe të ndjeshme ndaj

kërkesave gjinore, ciklit jetësor dhe privatësisë. Siguria fizike nuk duhet të jetë kërcënuar gjatë aksesit në objektet dhe shërbimet ujore;

(ii) *Aksesueshmëria ekonomike*: Uji dhe objektet e shërbimet e ujit duhet të jenë të përballueshme për të gjithë. Kostot dhe tarifat direkte dhe indirekte që lidhen me sigurimin e ujit duhet të jenë të përballueshme dhe nuk duhet të rrezikojnë ose kërcënojnë realizimin e të drejtave të tjera të Paktit;

(iii) *Mosdiskriminimi*: Uji dhe objektet e shërbimet e ujit, duhet të jenë të aksesueshme për të gjithë, duke përfshirë shtresat më të cenueshme ose më të marginalizuara të popullsisë, *në ligj (de jure)* dhe *në fakt (de facto)*, pa diskriminim për asnjë nga shkaqet e ndaluara; dhe

(iv) *Aksesueshmëria në informacion*: aksesueshmëria përfshin të drejtën për të kërkuar, marrë dhe dhënë informacion në lidhje me çështjet e ujit.

Shtetet palë kanë një detyrim të veçantë për t'u siguruar atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme, ujin dhe pajisjet e nevojshme, për të parandaluar çdo diskriminim, bazuar në shkaqet e ndaluara/mbrojtura. Ndërsa e drejta për ujë vlen për të gjithë, shtetet palë duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë atyre individëve dhe grupeve që tradicionalisht janë përballur me vështirësi në ushtrimin e kësaj të drejte, duke përfshirë, minoritetet apo personat me aftësi të kufizuara.

Ndërsa Pakti parashikon realizimin progresiv dhe pranon kufizimet për shkak të kufijve të burimeve të disponueshme, ai gjithashtu u imponon shteteve palë detyrime që kanë efekt të menjëhershëm. Shtetet palë kanë detyrime të menjëhershme në lidhje me të drejtën për ujë, të tilla si, garancia që e drejta do të ushtrohet pa asnjë lloj diskriminimi dhe detyrimi për të ndërmarrë hapa drejt realizimit të plotë. Komiteti, ka identifikuar një sërë detyrimesh thelbësore në lidhje me të drejtën për ujë, të cilat kanë efekt të menjëhershëm, ku ndër të tjera përfshihen:

- Të sigurojë sasinë minimale thelbësore të ujit, e cila është e mjaftueshme dhe e sigurt për përdorime personale dhe shtëpiake për të parandaluar sëmundjet;
- Të sigurojë të drejtën e aksesit për ujë dhe në objektet dhe shërbimet e ujit mbi baza jodiskriminuese, veçanërisht për grupet e pafavorizuara ose të marginalizuara;
- Të miratojë programe të synuara me kosto të ulët për të mbrojtur grupet e cenueshme dhe të marginalizuara;

Duhet të theksohet se një shtet palë nuk mund të justifikojë mospërputhjen e tij me detyrimet thelbësore, të cilat janë të paderogueshme.

E drejta për ujë, si çdo e drejtë e njeriut, imponon tre lloje detyrimesh për shtetet palë: *detyrimet për të respektuar, detyrimet për të mbrojtur dhe detyrimet për të përmbushur*.

Detyrimi për të respektuar kërkon që shtetet palë të përmbahen nga ndërhyrja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë në gëzimin e të drejtës për ujë. Detyrimi përfshin, ndër të tjera, mospërfshirjen nga çdo praktikë ose aktivitet që mohon ose kufizon e aksesin e barabartë në ujë të mjaftueshëm.

Detyrimi për të mbrojtur kërkon që shtetet palë të parandalojnë palët e treta që të ndërhyjnë në çfarëdo mënyre në gëzimin e të drejtës për ujë.

Detyrimi për të përmbushur mund të ndahet në *detyrimet për të lehtësuar, promovuar dhe siguruar*. *Detyrimi për të lehtësuar* kërkon që shteti të marrë masa pozitive për të ndihmuar individët dhe komunitetet që të gëzojnë të drejtën. *Detyrimi për të promovuar* detyron shtetin palë të ndërmarrë hapa për të siguruar edukimin e duhur në lidhje me përdorimin higjienik të ujit, mbrojtjen e burimeve ujore dhe metodat për të minimizuar humbjen e ujit. Shtetet palë janë gjithashtu të *detyruara të përmbushin (sigurojnë)* të drejtën kur individët ose një grup nuk janë në gjendje, për arsye jashtë kontrollit të tyre, ta realizojnë vetë këtë të drejtë me mjetet që kanë në dispozicion.

Duke ju rikthyer çështjes objekt shqyrtimi, si dhe bazuar në standardet e mësipërme sipas të cilave duhet të sigurohet e drejta e njeriut për ujë, Komisioneri vlerëson se:

Në radhë të parë, është e papranueshme dhe një praktikë e cila duhet shmangur, ndërprerja e furnizimit me ujë, duke mohuar plotësisht aksesin në ujë për kategoritë vulnerabël sikurse në rastin konkret është ankuesja, e cila është një person, grua kryefamiljare e divorcuar, që trajtohet me ndihmë ekonomike apo individëve ose një grup i individësh, që nuk janë në gjendje, për arsye jashtë kontrollit të tyre, ta realizojnë vetë këtë të drejtë me mjetet që kanë në dispozicion, pa siguruar sasinë minimale thelbësore të ujit, e cila është e mjaftueshme dhe e sigurt për përdorime personale dhe shtëpiake për të parandaluar sëmundjet.

Në radhë të dytë, Komisioneri konstaton se, skema e akt marrëveshjes e zbatuar në rastin e ankueses, në kushtet në të cilat gjendet ankuesja nuk është efektive. Komisioneri arrin në këtë përfundim duke konstatuar se, vlera e 1/5 të shumës së debisë prej 47.000 lekë, duke i shtuar vlerën e një fature nga vitet e kaluara dhe vlerën e faturës të muajit përkatës, që ankuesja duhet të paguajë për të shlyer detyrimet e prapambetura, të cilat ishin bërë shkak për ndërprerjen e furnizimit me ujë, nuk është e përballueshme ekonomikisht, në kushtet kur ankuesja ka si burim të ardhurash vetëm pagesën e ndihmës ekonomike.

Nga analizimi i dispozitave ligjore sipërcituar, si dhe referuar ngjarjeve e fakteve, objekt hetimi, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues është vënë në pozita të pafavorshme dhe është trajtuar në mënyrë të padrejtë nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a, përsa i takon ndërprerjes së furnizimit me ujë të pijshëm të banesës ku jeton ankuesja.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2⁵, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që

⁵“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo forme sjelljeje që nxit diskriminim”.

parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Në rastin në fjalë, pretendohet se znj. I.M është diskriminuar për më shumë se një shkak dhe konkretisht, për shkak të “gjinisë”, “gjendjes familjare ose martesore”, “gjendjes ekonomike”, “gjendjes shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se shkakun i pretenduar prej saj është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak.

Në lidhje me pretendimin për shkak të gjinisë, ankuesja pretendon se i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, pasi është një grua.

Në lidhje me pretendimin e ankuseses për diskriminim për shkak të “gjinisë”, Komisioneri gjykon se konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në nenin 1, të LMD.

Në lidhje me pretendimin për shkak të gjendjes familjare, ankuesja pretendon se i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, pasi është kryefamiljare e divorcuar.

Në kuptim të shpjegimit të shkaqeve të diskriminimit, sipas LMD-së, “*gjendja familjare⁶ ose martesore*”, ka të bëjë me marrëdhëniet martesore, farefisnore ose prindërore të cilat një person ka me persona tjerë. Gjendja familjare mund të ndryshojë ndërmjet individëve, pasi ata mund të jenë të martuar ose jo, në një marrëdhënie de facto ose në një marrëdhënie që nuk e njeh ligji, të divorcuar ose të ve, jetojnë në një familje të zgjeruar ose kanë përgjegjësi të ndryshme për fëmijët dhe personat e varur ose një numër të caktuar fëmijësh.

⁶ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

Në Komentet e Përgjithshme nr. 20, të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të Kombeve të Bashkuara, lidhur me shkakun për gjendjen familjare është shpeguar se: *“Statusi martesor dhe familjar mund të ndryshojë ndërmjet individëve sepse, ndër të tjera, ata janë të martuar ose të pamartuar, të martuar nën një regjim të caktuar ligjor, në një marrëdhënie de facto ose që nuk njihet me ligj, të divorcuar ose të ve, jetojnë në një familje të zgjeruar ose grup farefisnie ose kanë lloje të ndryshme përgjegjësie për fëmijët dhe vartësit ose një numër të caktuar fëmijësh.*

Trajtimi i ndryshëm në aksesin në përfitimet e sigurimeve shoqërore në bazë të faktit nëse një individ është i martuar duhet të justifikohet me kritere të arsyeshme dhe objektive. Në raste të caktuara, diskriminimi mund të ndodhë edhe kur një individ nuk është në gjendje të ushtrojë një të drejtë të mbrojtur nga Pakti për shkak të statusit të tij/saj familjar ose mund ta bëjë këtë vetëm me pëlqimin e bashkëshortit ose me pëlqimin ose garancinë e një të afërmi”.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se:

- Në Certifikatën familjare datë 14.07.2025, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile 96, Elbasan, rezulton se Znj. I.M është kryefamiljare e divorcuar me një djalë në moshë madhore.

Komisioneri konstaton se, shkakun e gjendjes familjare, të pretenduar si shkak diskriminimi nga pala ankuese, ka në bazë të tij faktin që ajo është kryefamiljare, ndërsa këtij statusi i shtohet gjendja se znj. I.M, si e divorcuar.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se ankuesja e mbart shkakun e *“gjendjes familjare”*.

Shkakun e gjendjes ekonomike, i referohet kryesisht situatës aktuale të një personi për sa i përket pasurisë, pronës, apo karakteristikave të tjera të ngjashme dhe që mund të ndryshojnë gjatë rrjedhës së jetës së një personi. *Gjendja ekonomike*, si shkak i ndaluar diskriminimi, kryesisht lidhet me individë, grupe individësh apo grupe shoqërore të cilët janë në pamundësi ekonomike për të përballuar një jetesë dinjitoze dhe kjo pamundësi reflekton në shumë fusha të jetës, në pamundësi shoqërore, arsimore, intelektuale, materiale, kulturore deri dhe ekzistenciale⁷.

Ankuesja ka depozituar dokumentacion me anën e të cilit provon shkakun e gjendjes ekonomike:

- Referuar Vërtetimit nr. 019474 serie, datë 29.05.2025 të Bashkisë Elbasan, znj. I.M, trajtohet me ndihmë ekonomike për dy persona në masën 3.703 lekë.
- Referuar Vërtetimit datë 27.05.2025 të DR AKPA Elbasan, znj. I.M është e regjistruar si punëkërkuese e papunë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi për diskriminimin e znj. I.M duhet të shqyrtohet bazuar në shkakun e *gjinisë, gjendjes familjare dhe gjendjes ekonomike*, pasi rezultoi e provuar se, znj. I.M i mbart këto shkaqe, si dhe LMD i parashikon si shkaqe të mbrojtura.

⁷ Shiko vendimin nr.104, date 7.06.2022, të Komisionerit, K.F kundër Ministrisë së Mbrojtjes: <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/06/Vendim-nr.-104-date-07.06.2022-K.F-kunder-Ministrise-se-Mbrojtjes-Diskriminim.pdf>

Shkak i gjendjes shëndetësore, si shkak i ndaluar diskriminimi, i referohet trajtimit ndryshe që i bëhet një personi dhe ky trajtim lidhet me gjendjen e tij shëndetësore.

Ankuesja ka depozituar një Referim elektronik nga Poliklinika e Specialiteteve nr. 2, Elbasan, datë 17.03.2025, nga mjeku endokrinolog me diagnozë: Znj. I.M, diabet mellitus tipi 2.

Lidhur me shkakun e gjendjes shëndetësore, Komisioneri vëren se bazuar mbi kuptimin e gjendjes shëndetësore, vetëm fakti që ankuesja ka një diagnozë të marrë dy muaj përpara se ti bëhej ndërprerja e furnizimit me ujë të pijshëm nuk mjafton për të justifikuar shkakun, për më tepër që ankuesja nuk ka dhënë asnjë shpjegim se si Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a ka qenë në dijeni të gjendjes së saj shëndetësore dhe se si ky shkak ka ndikuar në ndërprerjen e furnizimit me ujë të pijshëm të banesës.

Në këtë kuptim, Komisioneri vlerëson se edhe pse ankuesja e mbart këtë shkak, nuk ka fakte dhe prova mbi bazën e të cilave të ngrihet dyshimi, që trajtimi të cilit i është nënshtruar ankuesja, të ketë lidhje me këtë shkak.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ky shkak i pretenduar nga ankuesja nuk është i bazuar dhe nuk mund të pranohet.

B/4 Çdo shkak tjetër.

Ankuesja pretendon diskriminim edhe në kuadër të termit “*çdo shkak tjetër*”, por nuk ka identifikuar shkakun apo karakteristikën që sipas saj duhet të gëzojë mbrojtje nga diskriminimi, në kuadër të këtij parashikimi ligjor dhe në këtë kuptim, ky shkak i pretenduar nga ankuesja nuk është i bazuar.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm me shkaqet e mbrojtura.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Neni 18, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet ky parim parashikon: “*1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.*”. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, duke theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. (Vendimi nr. 18, datë 29.07.2008, Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009, Vendimi nr. 4, datë 12.02.2010, Vendimi nr. 31 datë 04.10.2021)

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (*Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përligjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese).

Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (*Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese*).

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë shoqëruese shkaqesh.

Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar:

“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;

b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;

c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;

d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

Në Komentin e Përgjithshëm Nr. 15 (2002) “*E drejta për ujë*”, Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në cilësinë e autoritetit i cili monitoron dhe interpreton Paktin, ofron udhëzime në lidhje me çështje thelbësore që lidhen me zbatimin e neneve 11 dhe 12, të Paktit Ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Një prej këtyre udhëzimeve, të cilat Komisioneri vlerëson se gjen zbatim në çështjen objekt shqyrtimi është pasqyruar si më poshtë:

Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 15 (2002) “*E drejta për ujë*” thekson se: “*E drejta e njeriut për ujë, i jep të drejtë të gjithë personave për ujë të mjaftueshëm, të sigurt, të pranueshëm, fizikisht të aksesueshëm dhe të përballueshëm për përdorim personal dhe shtëpiak*”.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si, çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në bazë të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në nenin 6, të tij, përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”.

Neni 20, në pikat 1, shkronja a) dhe pika 4, e LMD-së, parashikon se:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

.... a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

4. Refuzimi, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin edhe situata kur refuzimi në fakt bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, por nga subjekti diskriminues deklarohen shkaqe të tjera, apo nuk deklarohet asnjë arsye si shkak i refuzimit”.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose

nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁸.

Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu cenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁹. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme¹⁰. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14 nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar “pabarazitë faktike” ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14¹¹.

Në nenin 3, pika 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”. Ky ligj parashikon disa forma nëpërmjet të cilave mund të shfaqet sjellja diskriminuese, duke përcaktuar në nenin 3, pika 2 e 7, se: “2. *“Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji*. 7. *“Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë*”.

Në bazë të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”.

⁸ Shih: Molla kundër Greqisë, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; Fábíán kundër Hungarisë, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; Abdulaziz, Cabaes dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, 1985, prg.72.

⁹ Shih: Çështja Thlimmenos kundër Greqisë [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹⁰ Shih: Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹¹ Shih: Çështjen Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen Thlimmenos, cituar më lart, prg. 44; Çështjen D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

Në bazë të nenit 5, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet: “1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.

Sa më sipër rezulton se gëzimi dhe ushtrimi në të njëjtën mënyrë me të tjerët i të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe çdo të drejte tjetër që buron nga ligjet në fuqi, garantohet duke eliminuar diskriminimin formal dhe atë substancial. Diskriminimi mund të rezultojë jo vetëm nga trajtimi i ndryshëm i njerëzve në situata të njëjta (diskriminimi formal), por gjithashtu duke ofruar të njëjtin trajtim për njerëzit në situata të ndryshme (diskriminimi substancial). Ky i fundit quhet diskriminim “i tërthortë”, sepse nuk është trajtimi që ndryshon, por janë më tepër pasojat e atij trajtimi, që do të ndjehen ndryshe nga njerëzit me karakteristika të ndryshme. Referuar përkufizimit ligjor elementët diskriminimit e tërthortë janë si më poshtë:

- një dispozitë, kriter apo praktikë në dukje neutrale;
- që prek një grup të përcaktuar nga një “shkak i mbrojtur” në një mënyrë shumë më negative;
- duke krahasuar të tjerët në një situatë të ngjashme.

Kriteri i parë i identifikueshëm është një dispozitë, kriter ose praktikë neutrale. Me fjalë të tjera, duhet të ketë një kriter që zbatohet për të gjithë. Në rastin konkret, në pamje të parë të gjithë personat që janë debitorë të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a trajtohen në mënyrë të barabartë dhe nuk ka në pamje të parë asnjë ndalim, kufizim apo përjashtim për ndërprerjen e furnizimit me ujë për të gjithë debitorët në bazë të gjinisë, gjendjes familjare dhe gjendjes ekonomike.

Kriteri i dytë i identifikueshëm është se dispozita, kriteri ose praktika neutrale e vendos një “grup të mbrojtur” në një disavantazh të caktuar. Për këtë arsye diskriminimi i tërthortë ndryshon nga diskriminimi i drejtpërdrejtë sepse e zhvendos fokusin larg nga trajtimi i ndryshëm për të parë efektet e ndryshme.

Pra, ankuesja, për shkak të gjinisë, gjendjes familjare dhe gjendjes ekonomike nuk është në kushtet ekonomike që të mund të shlyejë debinë e kontratës së furnizimit me ujë. Në këto kushte ankuesja, e cila për shkak të gjinisë, gjendjes familjare dhe gjendjes ekonomike nuk i ka mundësitë për shlyerjen e debisë me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a, vendoset në kushte më pak të favorshme dhe ndikohet në mënyrë negative nga veprimi i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a, duke i ndërprerë furnizimin me ujë edhe pse ndërprerja e furnizimit me ujë për konsumatorët debitorë, kryhet në të njëjtën mënyrë për të gjithë.

Në kushtet kur ankuesja nuk është në gjendje që të shlyejë detyrimet financiare ndaj Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a, ajo vendoset në kushtet e pamundësisë për tu furnizuar me ujë krahasimisht me personat e tjerë që nuk ndodhen në të njëjtat kushte me të.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen

diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS¹² gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

Neni 33, pika 7/1 e LMD, ka parashikuar se: “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ-ja pranon si fakte ato vlerësime “...të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave.....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara¹³”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesja duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut/shkaqeve të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të padrejtë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun/shkaqet e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse Shoqëria Rajonale Ujësjellës

¹² Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

¹³ GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

Kanalizime Elbasan sh.a, që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojnë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹⁴

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është bazuar pikërisht në standartin e mësipërm të të provuarit, gjatë shqyrtimit dhe konkluzioneve të arritura, në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Gjatë arsyetimit në pjesën A, Komisioneri ka vlerëson se, subjekti ankues është vënë në pozita të pafavorshme dhe është trajtuar në mënyrë të padrejtë nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a, përse i takon ndërprerjes së furnizimit me ujë të pijshëm të banesës ku jeton.

Komisioneri vlerëson se, në rrethanat e mësipërme mund të konsiderohet si mjaftueshëm të besueshme dhe domethënëse për të krijuar një prezumim të fortë të diskriminimit të tërthortë. Prandaj, barra e provës duhet t'i kalojë Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a e cila duhet të tregonte se praktika e zbatuar (ndërprerja e furnizimit me ujë për klientët debitorë), pra dështimi për të trajtuar ndryshe personat të cilët për shkak të gjinisë, gjendjes familjare dhe gjendjes ekonomike, e kanë të pamundur që të kryerjë pagesën e furnizimit me ujë, bazohet në një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, pra, nëse ndjek një synim të ligjshëm dhe mjetet e arritjes së këtij synimi janë të përshtatshme e të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.

Bazuar në analizën e sipërcituar rezultoi se subjektit ankues, është banuese prej shumë vitesh në apartamentin ku jeton, dhe se është në proces gjyqësor me objekt vazhdimin e procesit të privatizimit të objektit dhe në këto kushte ajo është në pamundësi për të lidhur kontratë të re të furnizimit me ujë të pijshëm me Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a.

Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 15 (2002) *“E drejta për ujë”* thekson se: *“E drejta e njeriut për ujë, i jep të drejtë të gjithë personave për ujë të mjaftueshëm, të sigurt, të pranueshëm, fizikisht të aksesueshëm dhe të përballueshëm për përdorim personal dhe shtëpiak”*.

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a, mbajti qëndrimin se ka ndërprerë furnizimin me ujë të pijshëm për banesën ku jeton ankuesja, për arsye se kontrata është debitorë dhe se nuk ishte në dijeni të kushteve specifike të kishte znj. I.M.

Komisioneri vlerëson se, është në detyrimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a, që të sigurojë duke marrë të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme që personat që trajtohen me ndihmë ekonomike të jetojnë në kushte të përshtatshme, përfshi këtu furnizimin me ujë të pijshëm.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a ka qenë në dijeni të situatës gjyqësore dhe ekonomike, në të cilën ndodhej znj. I.M, pasi ishte

¹⁴https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

vënë në dijeni nga ankuesja me email-in datë 22.05.2025, si dhe ishte vënë në dijeni nga Komisioneri me shkresën nr. 855/1, datë 16.06.2025, dhe përsëri ka ndërmarrë veprimin e ndërprerjen së furnizimit me ujë të pijshëm të banesës ku jetonte ankuesja.

Gjithashtu, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a ka qenë në dijeni të debisë së kontratës që në vitin 2011 dhe nuk kishte ndërmarrë veprime për zgjidhjen e situatës, ndërkohë që dhe pasi është vënë në dijeni të situatës së veçantë që ndodhej znj. I.M, ka vendosur për ndërprerjen e furnizimit me ujë të banesës.

Rregullorja e furnizimit me ujë dhe për kanalizimet e miratuar me VKM-në nr. 1304, datë 11.12.2009, *“Për miratimin e modelit të Rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjellës Kanalizimeve sh.a.”*, është dokumenti kryesor që siguron një marrëdhënie ligjore të drejtë ndërmjet konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe furnizuesit të këtyre shërbimeve UK sh.a, që vepron në emër të pronarit të aseteve dhe njëkohësisht përgjegjësit ligjor për to, pra Pushteteve Vendore në përbërje të zonës së shërbimit.

Në nenin 4.5.2, pika 1, germa e, të VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 përcaktohet se: *“Ndërprerja e furnizimit me ujë. 1. Furnizimi ndërpritet në raste shumë të veçanta për të parandaluar ndonjë rrezik të menjëhershëm të sigurisë së personave apo rrjetit ujësjellës, si dhe për të eliminuar shqetësimet në furnizimin me ujë të konsumatorëve të tjerë, apo cënimi i cilësisë së ujit të pijshëm. UK _____ sh.a. ka të drejtë të ndërpresë furnizimin me ujë në këto raste: (e) Konsumatori me ndihmë sociale, do të furnizohet nga ndërmarrja 20l/person në ditë, falas, si dhe shoqëria do instalojë ujëmatësin me qëllim që konsumi i ujit përtej kësaj norme të paguhet. Lista e konsumatorit të favorizuar do të merret zyrtarisht nga bashkia/komuna e zonës së shërbimit të shoqërisë”.*

Referuar rregullores së sipërcituar, Komisioneri vlerëson se Këshilli i Ministrave ka përcaktuar qartë se konsumatorët me ndihmë sociale kanë të drejtë të furnizohen me ujë falas 20 litra për person në ditë, ndërkohë që Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a nuk ka bërë një vlerësim të situatës së znj. I.M, e cila trajtohet me ndihmë ekonomike dhe nuk është në gjendje që të paguajë debinë dhe konsumin mujor të furnizimit me ujë.

Sa më sipër, Komisioneri arriti në përfundimin se, praktika e ndjekur nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a, duke e trajtuar ankuesen në mënyrë të njëjtë me të gjithë personat e tjerë, e vendos në kushtë të pafavorshme dhe e ekspozon atë ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, duke i mohuar të drejtën për të përfutur nga furnizimi me ujë, nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a. Si pasojë, znj. I.M është detyruar të jetojë në kushte të papërshtatshme banimi.

Gjithashtu, Komisioneri konstaton se, skema e akt marrëveshjes e zbatuar në rastin e ankueses, në kushtet në të cilat gjendet ankuesja nuk është efektive. Komisioneri arrin në këtë përfundim duke konstatuar se, vlera e 1/5 të shumës së debisë prej 47.000 lekë, duke i shtuar vlerën e një fature nga vitet e kaluara dhe vlerën e faturës të muajit përkatës, që ankuesja duhet të paguajë për të

shlyer detyrimet e prapambetura, të cilat ishin bërë shkak për ndërprerjen e furnizimit me ujë, nuk është e përballueshme ekonomikisht, në kushtet kur ankuesja ka si burim të ardhurash vetëm pagesën e ndihmës ekonomike.

Në nenin 3, pika 3 të ligjit 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *““Diskriminim ndërsektorial” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit”*.

Komisioneri vlerëson se, pretendimi për diskriminim ndaj znj. I.M, duhet të vlerësohet në kuadër të parashikimeve të nenit 3, pika 3, të LMD, pasi pretendohet se ankuesja është diskriminuar si pasojë e ndërveprimit të më shumë se një shkakut dhe konkretisht, gjinisë, gjendjes familjare dhe ekonomike, shkaqe të cilat kanë bashkëvepruar me njëra tjetrën në mënyrë të pandashme dhe në të njëjtën kohë për të prodhuar situatën e diskriminimit të tërthortë, të cilës i është nënshtruar znj. I.M si rezultat i ndërprerjes së furnizimit me ujë, pasi nuk identifikohen momente të veçanta të veprimit të njërit apo tjetrit shkak mbi situatën.

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave CEDAW), në pjesën hyrëse, të nenit 2, parashikon, të: *“Shtetet palë dënojnë diskriminimin ndaj grave në të gjitha format, pranojnë të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtashme dhe pa vonesë, një politikë të eliminimit të diskriminimit kundrejt grave... ”*. Në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga parashikimet e nenit 2, të Konventës CEDAW, në Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 28 (2010) mbi detyrimet thelbësore të shteteve palë, sipas nenit 2 të Konventës, Komiteti CEDAW, sqaron se: *“Ndërsektorialiteti është një koncept bazë për të kuptuar shtrirjen e detyrimeve të përgjithshme të shteteve palë të përfshira në nenin 2. Diskriminimi i grave në bazë të seksit dhe gjinisë është i lidhur pazgjidhshmërisht me faktorë të tjerë që prekin gratë, si raca, përkatësia etnike, feja ose besimi, shëndeti, statusi, mosha, klasa, kasta dhe orientimi seksual dhe identiteti gjinor. Diskriminimi në bazë të seksit ose gjinisë mund të prekë gratë që i përkasin grupeve të tilla në një shkallë të ndryshme ose në mënyra të ndryshme nga burrat”*.

Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 16 (2005) *“E drejta e barabartë e burrave dhe grave për të gëzuar të gjitha të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (neni 3 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore)”* evidenton se : *“Grave shpesh u mohohet gëzimi i barabartë i të drejtave të tyre njerëzore, veçanërisht për shkak të statusit më të vogël që u është caktuar atyre nga tradita dhe zakonet, ose si rezultat i diskriminimit të hapur ose të fshehtë. Shumë gra përjetojnë forma të ndryshme diskriminimi për shkak të ndërthurjes së seksit me faktorë të tillë si, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinionet politike dhe të tjera, origjina kombëtare ose sociale, pasuria, lindja ose statusi tjetër, si mosha, përkatësia etnike, aftësia e kufizuar, gjendja martesore, statusi i refugjatit ose migrantit, duke rezultuar në disavantazh kompleks.”*

Komisioneri evidenton se, gjinia, si dhe gjendja familjare dhe ekonomike e znj. I.M, janë fakte të njohura për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet (diskriminimi *prima facie*) se në pamje të parë znj. I.M, është diskriminuar për shkak të gjinisë, gjendjes familjare dhe ekonomike, në të drejtën e saj për furnizimin me ujë të pijshëm.

Komisioneri vlerëson se, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a ka treguar një qëndrim pasiv të pajustificuar në lidhje me trajtimin e znj. I.M, pavarësisht se ka qenë në dijeni të vulnerabiliteteve të shtuara të saj, si grua kryefamiljare e divorcuar ku burimi i vetëm për të siguruar jetesën është ndihma ekonomike. Në këtë kontekst Komisioneri gjykon se Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a nuk e ka trajtuar në mënyrë efektive rastin e znj. I.M në raport me faktin se ajo i përken një grupi të disavantazhuar në disa drejtime, çka sjell si pasojë një disavantash kompleks.

Bazuar në tërësinë e fakteve dhe provave të administruara në lidhje me rastin konkret të znj. I.M, Komisioneri vlerëson se Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a dështoi që të jepte një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, sa i takon trajtimin të padrejtë dhe të pafavorshëm të cilit i është nënshtruar znj. I.M.

Komisioneri arrin në përfundimin se, znj. I.M është diskriminuar në të drejtën për furnizim me ujë, në formën e diskriminimit ndërsektorial dhe të tërthortë për shkak të gjinisë, gjendjes familjare dhe gjendjes ekonomike, si rezultat i refuzimit të kërkesës për të përfituar furnizimin me ujë, nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a. Për rrjedhojë Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a, ka shkelur ndalimin e diskriminimit, të parashikuar nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre*”, ndërsa në nenin 33, pika 12, përcaktohet se : “*Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës*”

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 33/10, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit. Ky ligj, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese është marrja e masave nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a, që të ndalojë aplikimin e praktikës së ndërprerjes së furnizimit me ujë për shkak të mospagesës së detyrimeve nga ana e klientëve, për individët ose grupet e individëve vulnerabël, ku përfshihen edhe personat ose grupet e personave të cilët për shkak të gjendjes ekonomike janë

në pamundësi financiare për të shlyer detyrimin, sikurse janë personat që përfitojnë ndihmë ekonomike. Në lidhje me rastin e ankueses, Komisioneri kërkon nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a që të rishikojë Akt Marrëveshjen e lidhur me ankuesen, duke zvogëluar këstin mujor që ankuesja është e detyruar të paguaj për shlyerjen e detyrimit të prapambetur, në atë masë që të jetë e përballueshme nga ana e ankueses.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin nenet 32 e 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të ankueses Znj. I.M, për shkak të gjinisë, gjendjes familjare dhe gjendjes ekonomike, në formën e diskriminimit ndërsektorial dhe të tërthortë nga ana e Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a.
2. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a të marrë masa për furnizimin me ujë të pijshëm për banesën e ankueses.
3. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a të rishikojë Akt Marrëveshjen e lidhur me ankuesen, duke zvogëluar këstin mujor që ankuesja është e detyruar të paguaj për shlyerjen e detyrimit të prapambetur, në atë masë që të jetë e përballueshme nga ana e saj.
4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 13, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA